


Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 534/24 - 02/10  
Nr. i Fq./Br. Sc./No. Fq. 1/3  
Data/Datum/Date: 19.08.2024  
PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



**Vendimi Nr.73/24**

**Datë: 19.08.2024**

Duke u bazuar në nenet, 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimin Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të raportit të sekretariatit, në mbledhjen e datës, 19.08.2024, mori këtë:

### V E N D I M

**I. LEJOHET**, Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me marrjen e kontrollit dhe blerjen e 80% të aksioneve nga MESNA INDUSTRIJA BRAĆA PIVAC mbi kompaninë e synuar CM Invest GmbH.

**II. Parashtruesi** i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55 paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 15.07.2024, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 448/24-01/H për Njoftim të Përqendrimit, lidhur me blerjen e aksioneve dhe marrjen e kontrollit nga MESNA INDUSTRIJA BRAĆA PIVAC, mbi kompaninë e synuar CM Invest GmbH.

### Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë, 31.07.2024;
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me, datë 31.07.2024;
3. Palët kanë nënshkruar kontratën mbi shitblerjen e aksioneve me datë, 17 Maj 2024;

### Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar, e kalon shumën 20,000,000 Euro;

2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë, 1,000,000 Euro;
3. Njoftimi për Përqendrim është i bazuar në lidhjen e marrëveshjes, në mes të palëve të datës, 17.05.2024.

#### **Palët në transaksion:**

**MESNA INDUSTRIJA BRAĆA PIVAC**, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e inkuorporuar sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë, me adresë të regjistruar në rrugën Težačka 13, Vrgorac, Republika e Kroacisë, e regjistruar në Regjistrin Gjyqësor në Gjykatën e Qarkut në Split. Aktiviteti i saj është prodhimi dhe përpunimi i mishit, tregtisë, shërbimeve, turizmit, agjencive turistike.

**CM Invest GmbH**, është ndërmarrje holding me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe funksion sipas ligjeve të Republikës së Austrisë, me adresë të regjistruar në rrugën, Koschatstrasse 38,9020 Klagenfurt am Worthersee, Republika e Austrisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Republikës së Austrisë. Ajo mbanë 100% të aksioneve në Celjske mesnine d.o.o, një ndërmarrje e industrisë së mishit me adresë të regjistruar në Slloveni, e specializuar në prodhimin dhe shitjen e mishit të freskët dhe të ngrirë si dhe produkteve të mishit. Kompania e synuar është në pronësi të përbashkët të MIF Invest, e cila zotëron 40% të aksioneve, ndërsa, Amur Injzeniring trgovina d.o.o., zotëron 60% të aksioneve, prandaj të dy ndërmarrjet në vijim do të referohen bashkërisht si shitës të Kompanisë së Synuar.

**MIF Invest, poslove storive in upravljanje investicij D.o.o.**, një ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar, e inkuorporuar dhe që funksion sipas ligjeve të Republikës së Sllovakisë.

**Amur Injzeniring trgovina d.o.o.**, një ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar e inkuorporuar dhe që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Sllovenisë.

#### **Struktura e Përqendrimit**

Transaksioni i Propozuar ka të bëjë me blerjen nga Parashtruesi i kërkesës të 80% të aksioneve në Kompaninë e synuar, secili nga shitësit do t'i shesë blerësit aksionet të tyre përkatëse. Transaksioni i propozuar realizohet në bazë të marrëveshjeve, që kanë lidhur ndërmarrjet në mes veti. Ndërsa Radgonske Gorice d.o.o., e cila është gjithashtu nën pronësinë e Celjske Mesnine d.o.o. me 96.52% të aksioneve, Parashtruesi i Kërkesës nuk synon që të njëjtën ta marrë nën pronësi. Në këtë drejtim, aksionet në Radgonske Gorice Geld nga Celjske mesnine, do t'i transferohen Amur injzeniring si pjesë e çmimit të Transaksionit të Propozuar sipas Marrëveshjes 2.

#### **Tregu përkatës:**

**Tregu i produktit**, do të konsiderohet tregu i mishit dhe produkteve të mishit

**Tregu gjeografik**, në transaksionin e propozuar përkufizohet si treg i hapur.

#### **Analiza e konkurrencës**

Pas analizave transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte në konkurrencën e Kosovës, duke pasur parasysh se asnjëra nga palët nuk është e pranishme në tregun përkatës të propozuar. Transaksioni nuk do të shkaktojë, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në tregun kosovar, dhe rrjedhimisht nuk do të shkaktojë ndryshim në strukturën e tregut në Kosovë. Palët nuk kanë mbivendosje horizontale apo vertikale në Kosovë,

andaj transaksioni si i tillë nuk ngritë shqetësimin për konkurrencën dhe as për konsumatorët në Republikën e Kosovës.


### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se, palët njoftuese në transaksionin e propozuar janë prezentë në Kosovë, përmes ndërmarrjes Kraš prehrambena industrija d.d. që ka një klient në një kompani, që është aktive në Kosovë. Pra transaksioni nuk do të rezultojë në asnjë ndryshim në strukturën e tregut relevant në Kosovë, andaj transaksioni i propozuar nuk do të çojë në ndonjë çrregullim, kufizim ose parandalim, apo shtimbërim të konkurrencës në Kosovë. Transaksioni në veçanti, nuk do të çojë në krijimin ose forcimin e një pozitë dominuese. Transaksioni pritet të ndikojë vetëm në tregjet e Sllovenisë, Kroacisë. Transaksioni i propozuar nuk do të ndikojë në konkurrencën në Kosovë, dhe është në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## **AUTORITETI I KONKURENCËS KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva